



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRES
ZYRA VENDORE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE SHIJAK

Shijak më 14.07.2025

NJOFTIM

**PËR FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË KONKURIMIT PËR MËSUES
KOORDINATORE PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË SHKOLLË**

Bazuar në Ligjin Nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr 14 datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimor në institucionet e arsimit parauniversitar, të Udhëzimit Nr. 8, datë 08.05.2024 , të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë , Urdhëri nr 463 date 30.08.2024 “ Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e mesuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe të mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”. Shkresa nr 2946/3 Prot datë 18.09.2024 e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Mbi numrin e mitatuar të mësuesve koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mësuesve koordinator të këshillimit të karrierës , shkresës nr 1790 date 11.07.2025, të AKAP për realizimin e procedurave të konkurimit të kandidatëve për mesuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mesuesit koordinator të këshillimit të karrierës.

Njoftojmë të gjithë kandidatëve e interesuar për koordinator cilësie Bazuar në urdhërin nr 463 datë 30.08.2024 “ Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e mesuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe të mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”. Pika 4 si më poshte

Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë , duhet të jetë pjesë e sistemit arsimor dhe duhet të plotesoje kriteret si më poshtë”

- a) Të këtë 8 vite punë si mësues , nga të cilat 5 vitë në shkollën ku punon dhe aplikon për mësues koordinator të sigurimit të cilësisë osë në shkollën më numër më të madh nxënësish.
- b) Të këtë kategorinë “ Mësues Specialist” me rezultat “ shumë mire” ose Shkëlqyeshëm” Avantazh përbën rezultati “ Shkëlqyeshëm”
- c) Të jetë vlerësuar në matjen e performances vjetore të mësuesit me vlerësimin “Shumë mire” për tri vite radhazi.
- d) Të këtë kryer prezantimin e një projekti novator për zhvillimin e lëndës, që dëshmohehet nga intitucioni arsimor përkatës.
- e) Të këtë njohuri të gjuhës angleze dhe aftësi shumë të mira kompjuterike.

Bahkelidhur lista me vendin vakant , afati për dorrezimin e dosjeve në ZVAP Shijak është data 18.07.2025 në rrugë zyretare :

Adresa: Lagjia Kodër Shijak .

| DRAP | ZVAP | Koordinator Cilësie/Koordinator Karriere | SHKOLLA KU EMËROHET | Lloji i shkolles Gjimnaz/9- vj/ SHMB | SHKOLLA/SHKOLLAT QË MBULON (Qend. me drejtori) | Numri i nxënësve për çdo shkollë | Nr. Total |
|--------|--------|--|--------------------------|---|---|---|--------------|
| DURRES | SHIJAK | Koordinator Cilësie | 16 SHTATORI / 9 -vjecare | gjimnaz/ 9vj | Gjimnazi 16 Shtatori : Kajo Karrafili , Shkolla 9-vjeçare Hamza Shahini, Rilindja , Kuvajt. | Gjimnazi 16 Shtatori 258, Gjimnazi Kajo Karafili 82, Shkolla 9-vjecare Kuvajt 193, Shkolla 9 vjecare Rilindja 128, Shkolla 9 vjecare Hamza Shahini 118. | 779 |